

Udhëzues për Konsumatorët në Tregun e Hapur të Energjisë Elektrike

Sqarim: Ky udhëzues është prëgatitur duke marr për bazë diskutimet, pyetjet dhe sqarimet e dhëna nga pjesëmarrësit e punëtorive të organizuara me qëllim të informimit të konsumatorëve rreth të rolit dhe përgjegjësisë të akterëve të ndryshëm në procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike. Ky dokument synon të udhëzojë konsumatorët për të bërë zgjedhje të informuara në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike.

1. Bazat Ligjore dhe Korniza Rregullative

- Tregu është i liberalizuar në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-085 dhe aktet nënligjore të ZRRE.
- Konsumatorët kanë të drejtë të zgjedhin furnizuesin e tyre dhe të negociojnë kushtet e furnizimit.
- Ndërrimi i furnizuesit duhet të përfundojë brenda 30 ditësh.

2. Çfarë është Tregu i Lirë?

- Furnizuesit konkurojnë për të ofruar çmime dhe kushte më të mira.
 - Çmimi nuk është më i rregulluar nga ZRRE, por negociohet drejtpërdrejt.
 - ZRRE rregullon dhe vendos tarifat për shfrytëzimin e rjetit të shpërndarjes (KEDS) dhe transmissionit (KOSTT).
 - Tregu funksionon në bazë të ofertës dhe kërkesës – çmimet janë dinamike.
 - Furnizuesit mund të ofrojnë çmime dinamike, fikse për një periudhë të caktuar, apo edhe kombinim të indekseve të ndryshme.

3. Si të Përcillni Procesin e Ndërrimit të Furnizuesit

- Analizoni profilin tuaj të ngarkesës – ky është informacioni bazë që kërkohet nga furnizuesit. Profilin tuaj të ngarkesës mund ta merrni nga KEDS.
- Kërkoni dhe krahasoni oferta nga furnizues të ndryshëm.
- Nënshkruani kontratë me ofertuesin më të favorshëm.
- Furnizuesi njofton operatorin e sistemit për kalimin në bazë të kontratës.

4. Roli i Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF)

- Nëse nuk keni kontratë aktive nga 1 Qershori 2025, KEK, si FMF, ju furnizon përkohësisht deri 60 ditë.
- Mos e konsideroni FMF si zgjidhje afatgjatë.
- Ky furnizim mund edhe mos të jetë më i favorshmi ekonomikisht për ju – duhet të gjeni furnizues të rregullt sa më parë.

5. Profili i Ngarkesës – Domosdoshmëri për Konsumatorët

- Profili përshkruan shpërndarjen orare të konsumit të energjisë.
- Konsumatorët pa njëhësorë intervali duhet të përdorin profile standarde të cilat i ka për obligim t'i përpiloj KEDS si Operator i Sistemit të Shpërndarjes.
 - Ju apo Furnizuesi juaj keni të drejtë të kërkoni këtë profil nga KEDS. Kontaktoni KEDS në email adresën kujtim.hoxha@keds-energy.com lidhur me këtë.
- Furnizuesit përdorin këtë profil për të llogaritur ofertat dhe për të balancuar ngarkesën në treg.

6. Optimizimi i Konsumit bazuar në Çmimet Ditore

- Konsumatorët që posedojnë njëhësorë intervali mund të analizojnë çmimet e publikuara dhe të zhvendosin konsumin në orët me çmime më të ulëta.
- Ky optimizim është i rëndësishëm për konsumatorët industrialë dhe bizneset që mund të ndryshojnë orarin e punës ose të përdorin burime alternative gjatë pikut.

7. Pyetje që Konsumatorët Duhet të Shtrojnë Furnizuesve

- Çfarë modeli çmimi mund të përfshijë ofertat për furnizim (fiks, të indeksuar në ALPEX, HUPLEX apo bursa të tjera, variabël)?
 - Nëse është i indeksuar në bursa, diskutoni nëse aplikohet çmimi për orë, mesatare ditore, javore apo mujore, mesatare e produktit bazë, pik, apo jo-pik, etj.
 - Diskutojeni me furnizuesin e mundshëm nëse keni mundësi të optimizoni konsumin tuaj në raport me çmimet për orë, bazë apo pik.
 - Nëse vendosen limite rreth volumit të caktuar, pra nuk është kontratë për furnizim të plotë, duhet diskutuar edhe përgjegjësinë financiare ndaj imbalancave.
 - Shikojeni nëse njëhësori i energjisë elektrike dhe pajisjet që shfrytëzojnë ua mundësojnë këtë.
 - Monitoroni konsumin tuaj të energjisë elektrike dhe ku është e mundur reduktoni konsumin për të reduktuar kostot.
- Cilat janë tarifat për kapacitetin ndërkufitar (ndër-zonal) nëse të njëjtat janë future si komponentë e çmimit (mund të aplikohet nëse çmimi për energji është i indeksuar në bursa rajonale)?
 - Cili ankand dhe cilët kufijë mirren si reference?
 - Në çfarë forme garantohej 'rruga' më efektive ekonomike?
- Si aplikohen kostot nga tarifat e KOSTT dhe KEDS?
- A ka ndihmë teknike, nga Furnizuesi, për menaxhimin e konsumit?
- A ka penalitete për përfundim të hershëm të kontratës?
- Me çka më garantohej kualiteti i shërbimit?
- Si do të më njoftoni për ndërprerjet?
- Çfarë mbulon kompensimi në rast defekti ose ndërprerjeje?
- Kërkoni ndihmë nga ZRRE nëse keni paqartësi lidhur me të drejtat dhe obligimet tuaja si konsumatorë. Dërgoni pyetjet tuaja në email adresën e ZRRE-së: info@ero-ks.org.
- ZRRE ka gjithashtu mandatin për të monitoruar tregun dhe për të mbrojtur konsumatorët ndaj ofertave abuzive nga furnizuesit.

8. Vendimet e ZRRE-së rreth tarifave të KOSTT dhe KEDS

- Vendimin rreth tarifave të aplikuar të KOSTT mund ta gjeni [këtu](#).
 - Meqë Furnizuesi juaj i paguan KOSTT-it në emër të konsumit tuaj, tarifat e aplikueshme do t'ju faturohen nga Furnizuesi, si kumulativ i këtyre kategorive tarifore:
 - Shfrytëzimit të sistemit të transmissioinit, niveli 400/220 kV (2.087 EUR/kW/vit), dhe
 - Shfrytëzimit të sistemit të transmissioinit, niveli 110 kV (4.939 EUR/kW/vit), dhe
 - Operimi i Sistemit (4,644 EUR/MWh), dhe
 - Operimi i Tregut (0.018 EUR/MWh), dhe
 - Fondi i BRE-ve (2.924 EUR/MWh).

- Tarifa për shfrytëzim të rrjetit të transmisionit aplikohet në bazë të ngarkesës maksimale e konvertuar në MWh. Duke referuar pikut të sistemit, tarifa mesatare për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit është rreth 1.4 EUR/MWh.
- Vendimin rreth tarifave të aplikuara të KEDS mund ta gjeni [këtu](#).
 - Meqë Furnizuesi juaj i paguan KEDS-it në emër të konsumit tuaj, tarifat e aplikueshme do t'ju faturohen nga Furnizuesi, varësisht nga niveli i tensionit njuhësori juaj është i kyçur:
 - Niveli i tensionit 35 kV, ose
 - Niveli i tensionit 10 kV, ose
 - Niveli i tensionit 0.4 kV.

9. Shembulli i kalkulimit të çmimit final mbi bazën e një profili standard të ngarkesës

- Shembulli mëposhtë bazohet në:
 - një konsum standard të ngarkesës,
 - çmimin orë-për-orë të HUPEX,
 - kapaciteti ndërkufitar ditor HU->RS, RS-MK, MK-KS,
 - pagesa për KOSTT-in dhe KEDS-in,
 - 10% marginë të Furnizuesit.
- Shembulli bazohet në çmimet nga data 11 Qershor 2025.
 - Diagram paraqet vizualisht komponentet e çmimit,
 - Tabela mëposhtë paraqet kalkulimin.

Shembulli i referohet HUPX për të demonstruar përfshirjen e kapacitetit ndërkufitar, sidoqoftë për të evituar ekspozimin në kostot ndërkufitare, rekomandohet të shfrytëzohen çmimet në ALPEX Kosovë.

Diagrami: Struktura e plote e çmimit (me HUPX si indeks)




Tabela: Kalkulimi i çmimit me pakicë

A	B	C	D	E	F	G	B*(C+D+E+F) (adding 10%)
Ora	Konsumi ne kW	HUPX DAM (EUR/kWh)	XB capacity (EUR/kWh)	KOSTT (EUR/kWh) (TNUOS, SO, MO, BRE)	KEDS (EUR/kWh) (DNUOS)	Supplier margin (10%)	Retail price with HUPX (EUR)
1	0.1068	0.0818	0.0003	0.0090	0.0346	10%	0.0148
2	0.1068	0.0757	0.0004	0.0090	0.0346	10%	0.0141
3	0.1068	0.0693	0.0004	0.0090	0.0346	10%	0.0133
4	0.1068	0.0725	0.0002	0.0090	0.0346	10%	0.0137
5	0.1068	0.0733	0.0002	0.0090	0.0346	10%	0.0138
6	0.1068	0.0855	0.0006	0.0090	0.0346	10%	0.0152
7	6.4087	0.1090	0.0011	0.0090	0.0346	10%	1.0835
8	6.4087	0.1066	0.0006	0.0090	0.0346	10%	1.0629
9	6.4087	0.0831	0.0006	0.0090	0.0346	10%	0.8973
10	10.1471	0.0605	0.0052	0.0090	0.0346	10%	1.2194
11	10.1471	0.0202	0.0051	0.0090	0.0346	10%	0.7695
12	10.1471	0.0012	0.0054	0.0090	0.0346	10%	0.5608
13	9.6131	0.0043	0.0077	0.0090	0.0346	10%	0.5881
14	9.6131	0.0086	0.0080	0.0090	0.0346	10%	0.6364
15	9.6131	0.0129	0.0072	0.0090	0.0346	10%	0.6732
16	8.0109	0.0295	0.0093	0.0090	0.0346	10%	0.7256
17	8.0109	0.0717	0.0080	0.0090	0.0346	10%	1.0864
18	8.0109	0.1031	0.0025	0.0090	0.0346	10%	1.3148
19	1.6022	0.1117	0.0041	0.0090	0.0346	10%	0.2809
20	1.6022	0.1498	0.0029	0.0090	0.0346	10%	0.3460
21	1.6022	0.2192	0.0023	0.0090	0.0346	10%	0.4672
22	0.5341	0.1857	0.0004	0.0090	0.0346	10%	0.1349
23	0.5341	0.1231	0.0002	0.0090	0.0346	10%	0.0980
24	0.5341	0.1032	0.0002	0.0090	0.0346	10%	0.0864
Total	109.5890			0.2158	0.8304		12.1159
Max	10.1471	0.2192	0.0093				1.3148
Average	4.5662	0.0817	0.0030			10%	0.5048
Min	0.1068	0.0012	0.0002				0.0133